

1.

Sa është numri i fluturimeve me vonesa dhe raporti i tyre me fluturimet në total, performuar nga aeroporti i Tiranës dhe/ose me destinacion aeroportin e Tiranës. Sa është numri i fluturimeve përgjatë vitit 2023 dhe 5 muajve të parë të vitit 2024, që janë shtyrë për disa orë, pra fluturimi ka nisur me vonesë (edhe ato me më pak se 3 orë)?

Gjatë vitit 2023 numri i fluturimeve (ulje+ ngritje) në Aeroportin e Tiranës arriti shifrën 50 492. Nga ky numër total fluturimesh vlerësohet se 620 fluturime janë nisur me vonesa nga TIA drejt destinacioneve të tjera, ose 2.4% vonesa për 100 fluturime. Theksojmë se Autoriteti i Aviacionit Civil administron të dhëna për vonesa dhe anulime vetëm për operimet me nisje nga Aeroporti i Tiranës. Për periudhën Janar – Maj 2024 numri i fluturimeve (ulje+ngritje) është në nivelin 25 020 fluturimeve (ulje+ngritje) dhe me nisje nga TIA evidentohen 223 vonesa, ose 1.7% vonesa për 100 fluturime. Theksojmë se vonesat me nisje nga TIA nuk krijohen për shkak të shërbimeve të ofruara nga TIA dhe Albcontrol, por për shkak të arsyeve të listuara në pikën 2 këtu.

2. Na rendisni aryet e vonesave të fluturimeve dhe çfarë është bërë për të rregulluar këtë handicap

Arsyet kryesore të vonesave janë sa më poshtë:

- Vonësë nga fluturimet paraardhëse të inicuar në aeroporte të Komunitetit Evropian apo jashtë saj
- Mungesë kapacitetesh në hapësirë për shkak të konfliktit me Ukrainën
- Mot i keq
- Greva të stafit të aviacionit
- Probleme/difekte teknike
- Mungesë ekuipazhi (vijim ende i rikuperimit pas Covid-19), si dhe limiteve të orëve të fluturimit të ekuipazhit në konformitet me kërkesat e kërkuara rregullatore.

Duke qenë se këto janë arsye të vonesave për të gjithë vendet e komunitetit evropian dhe jashtë saj, po bashkëpunohet ngushtë me të gjithë aktorët e fushës së aviacionit civil. Kështu po punohet me linjat ajrore, aeroportet dhe shërbimet e menaxhimit të trafikut ajror për të ulur vonesat. Specifikisht disa nga ndërhyrjet që janë vlerësuar të kenë ndikim direkt në uljen e numrit të vonesave dhe që po implementohen janë:

- Rritja e numrit të burimeve njerëzore nga kompanitë ajrore, aeroportet dhe shërbimet e trafikut ajror dhe trajnimi frekuent i tyre
- Shtimi i pajisjeve për përsheptimin e shërbimeve të përpunimeve në tokë
- Përdorimi i teknologjisë në aeroport dhe shërbimet e përpunimit në tokë
- Shtimi i kapaciteteve aeroportuale si numri i portave dalëse (gate), numri i parkimeve, numri i vendeve për pasagjerët dhe bagazhet etj
- Mbledhje ditore me kompanitë ajrore, kryesisht loë cost, në lidhje me situacionet dhe problematikat operacionale me qëllim parashikimet e vonesave, njoftimet për to dhe riorganizimet aeroportuale dhe të trafikut ajror

- Organizimi i takimeve me operatorët ajrorë dhe aeroportet për evidentimin e problematikave dhe menyrave për zgjidhjen e tyre

-Ndjekja dhe vlerësimi i vazhdueshëm i performancës së operatorëve ajrorë dhe bashkëpunimi për nevoja përmirësuese.

- Në periudhën e fluksit më të lartë të fluturimeve, Autoriteti i Aviacionit Civil inspekton përmbushjen e standarteve të performancës për aeroportin dhe kompanitë ajrorë dhe mbi baza ditore te vlerësimit të të dhënave komunikon me këta aktorë dhe përcaktojnë së bashku ndërhyrjet e nevojshme

-Sensibilizimi i pasagjerëve jo vetëm për të drejtat e tyre, por edhe për detyrimet kur udhëtojnë nëpërmjet ajrit, si mënyrë për të reduktuar arsyet e vonesave për shkak të përjasjeve të pasagjerëve në të gjitha pikat e akesuara prej tij në aeroport etj.

- Konsultimi i herpashershëm i të dhënave të Eurocontrol dhe ICAO (Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil) për parashikime të vonesave duke qenë se përqindja më e madhe e tyre ndodhin për shkak të fluturimeve të mëparshme të ndodhura në destinacionin para mbërritjes në Aeroportin e Tiranës.

3. Sa ankesa kanë bërë qytetarët për kompanitë, që nuk kanë respektuar oraret? (numrin e ankesave për kompani)

Në tabelën më poshtë janë dhënë të dhënat në lidhje numrin e ankesave dhe kompensimeve të vlerësuara në raport me 1000 fluturime. Ankesat në drejtim të kompanisë ajrore Albawings nuk janë përfshirë dukw qenë se, për shkak të revokimit të licencës së operimit për arsye të revokimit të certifikatës së operatorit ajror, ankesat janë bërë subjekt i instancave ligjore.

Ankesat e pazgjidhura ende për vitin 2023 i referohen rasteve të pasagjerëve të cilët nuk i janë përgjigjur në vijimësi komunikimit të operatorit ose AAC-së duke mos dhënë të dhëna bankare për kompesim etj.

Tabela 1: Ankime dhe kompensime Janar – Dhjetor 2023

Nr	Kompanitë ajrore	Numri i fluturimeve (ulje+ngritje)	Numri i ankesave në AAC*	Numri i ankesave per 1000 fluturime	Kompensime
1	Air Albania	4748	46	10.1	42
2	Wizz Air	7928	115	14.6	105
3	Lufthansa	2082	12	5.76	4
4	Ryanair*	1320	3	2.27	1

*Shënim: *Autoriteti i Aviacionit Civil ka detyrimin të ndjekë vetëm ankesat që i drejtohen këtij Autoriteti nga pasagjerët, pa përfshirë ankesat që dërgohen direkt tek transportuesi ajror dhe AAC nuk njoftohet*

**Ryanair ka hyrë në tregun shqiptar në 25 Tetor 2023.*

Në tabelën 2 janë dhënë të njëjtat të dhëna si për tabelën 1, por për periudhën Janar – Maj 2024. Numri i ulët i kompensimeve shpjegohet me faktin që operatorët ajrorë marrin jo më pak se 6 javë për të trajtuar ankesën. Informacioni për fluturimet (ulje - ngritje) për këtë periudhe, për çdo operator, mungon për shkak se pritet informacionin për muajin Maj, i cili përcillet nga Albcontrol në fund të muajit Qershor 2024.

Tabela 2: Ankime dhe kompensime Janar – Maj 2024

Nr	Kompanitë ajrore	Numri i ankesave në AAC	Kompensime
1	Air Albania	42	23
2	Wizz Air	35	4
3	Lufthansa	7	3
4	Ryanair	2	0

4. Sa është vlera e dëmshpërblimeve të dhëna nga kompanitë për vonesa në fluturime apo anulim të fluturimeve gjatë vitit 2023

Autoriteti i Aviacionit Civil në funksionet dhe kompetencat e tij sipas bazës ligjore që rregullojnë zbatimin e të drejtave të pasagjerëve, nuk kërkon dhe mbledh informacion për vlerën e dëmshpërblimit që ka kryer çdo kompani ajrore, por vetëm mbështet pasagjerët në procesin e kompensimit ligjor që u takon, kur kërkohet nga këto të fundit.

5. A kanë marrë autoritetet shqiptare ndonjë masë për vonesat në fluturime? Dhe cilat kompani?

Autoriteti i Aviacionit Civil bazuar në funksionet e tij mbikëqyrëse dhe rregullbërëse ka gjithmonë në fokus marrjen e masave për mbarëvajtjen e të gjitha proceseve që lidhen me aviacionin civil, bazuar tërësisht në bazën rregullatore që i mbështet ato. Në kuadër të masave parandaluese dhe përmirësuese AAC zhvillon aktivitete monitoruese, inspektuese dhe audituese të planifikuara dhe jo të planifikuara, të cilat bëhen element orientues për aeroportin, shërbimin e trafikut ajror dhe kompanitë ajrore në drejtim të zgjidhjes së problemeve dhe përmirësimeve të shërbimeve që ofrojnë. Paralelisht me këtë AAC ofron gjithmonë asistencën teknike sipas nevojës, nëpërmjet konsultimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me to. Në varësi të mbarëvajtjes së zbatimit ligjor të detyrimeve që rrjedhin për çdo njësi të sipërpërmendur, vlerësohet nëse nevojitet ndërhyrja me masa shtrënguese, por që kryesisht gjejnë zgjidhje me masat parandaluese dhe përmirësuese.

6. Çfarë mbrojtje i rezervon legjislacioni shqiptar për qytetarët?

Shteti shqiptar ka transpozuar rregulloren evropiane 261/2004 për të drejtat e pasagjerëve, e specifikisht Urdhri i Ministrisë nr.1, datë 26.2.2013 “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit dhe vonesës gjatë fluturimeve”, si dhe rregulloren evropiane 1107/2006 transpozuar me Urdhrin e Ministrisë Nr.326, datë 22.12.2014 “Për të drejtat e invalidëve dhe personave me aftësi të kufizuara lëvizëse kur udhëtojnë nëpërmjet ajrit”. Në kuadër të këtyre Urdhrave të gjithë aktorët e përfshirë zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe Autoriteti i Aviacionit Civil monitoron në mënyrë frekvente zbatimin e tyre. Gjithashtu, AAC ka njësi të dedikuar për mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve që udhëtojnë nëpërmjet ajrit, strukturë e cila ofron shërbim ndaj pasagjerëve për çdo nevojë të tyre të lidhur me bazën e mësipërme rregullatore.